REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 663-688/22
Datë/Datum. 30.12.22
PRISHTINË - PRIŠTINA

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë. Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

**PSH. nr. 663/22**
**688/22**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: Vedat Poterqoi- Kryetar, Kimete Gashi- Anëtare, Agon Ramadani- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik (GOE) "Linda" & "Euroinfrastruktura", si dhe ankesës së operatorit ekonomik (OE) "Bujar Shabani B.I " Ferizaj", lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Asfaltimi i rrugës 14 Dhjetori" me nr. të prokurimit: 617-22-11189-5-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna e Shtime, me datën 30.12.2022, mori këtë:

## V E N D I M

1. **Aprovohet,** e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Linda" & "Euroinfrastruktura", e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 15. 11. 2022 me numër protokolli 663/2022, ndërkaq **Refuzohet,** si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik ankues "Bujar Shabani B.I " Ferizaj" e parashtruar në OSHP me datën 21. 11. 2022, për aktivitetin e prokurimit "Asfaltimi i rrugës 14 Dhjetori" me nr. të prokurimit: 617-22-11189-5-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna e Shtime.

2. **Anulohet,** njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit "Asfaltimi i rrugës 14 Dhjetori" me nr. të prokurimit: 617-22-11189-5-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna e Shtime dhe lënda kthehet në **rivlerësim.**

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues të OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, të precizuar me numër dhe datë si në paragrafët paraprak të dispozitivit të këtij vendimi.

4. OSHP mund të ndërmarr masa ndaj AK për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/ L-068, dhe Ligjin 05/L-092.

5. Meqenëse ankesa e operatorit ekonomik ankues "Bujar Shabani B.I " Ferizaj" refuzohet si e pabazuar, të njëjtit i konfiskohet tarifa e paguar me rastin e parashtrimit të ankesës në kuptim të nenit 31 paragrafi 5 i LPP-së dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

6. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Linda & Euroinfrastruktura", aprovohet si e bazuar i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A r s y e t i m

*- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Komuna Shtimje në cilësinë e autoritetit kontraktues me datën 13. 10. 2022 ka publikuar njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Asfaltimi i rrugës 14 Dhjetori" me nr. të prokurimit: 617-22-11189-5-2-1. AK ka parashikuar hapjen e ofertave me daten 24. 10. 2022. Njoftimi mbi vendimin për anulim te Autoritetit kontraktues: 08.11.2022, kërkesa për ri shqyrtim në AK me datë 08.11.2022, si vendimi për ri shqyrtim nga AK: 10.11.2022.

I pakënaqur me vendimin e AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim, OE me datën 15 nëntor 2022 ka parashtruar ankesë në OSHP.

Poashtu kundër vendimit të AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit, me datën 21 nëntor 2022 ankesë në OSHP ka parashtruar edhe operatori ekonomik "Bujar Shabani B.I " Ferizaj".

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë e hapur - punë, vlerë e mesme, kriteri i dhënies së kontratës tenderi i përgjegjshëm me çmimi më të ulët, vlera e parashikuar e kontratës nga AK është: 382,542.90 €.

*- Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

OSHP ka angazhuar ekspertin e jashtëm shqyrtues të prokurimit që në pajtim nenin 113 të LPP-së, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore i cili në raportin e datës 05.12.2022 ka rekomanduar që:

- Të aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE ankues "Linda & Euroinfrastruktura",
- Të refozhet si e pabazuar ankesa e OE "Bujar Shabani B.I " Ferizaj, si dhe;
- Të anulohet njoftimi për anulim i AK-së

Pretendimi ankimor për Operatorin ekonomik: "Linda & Euroinfrastruktura"- Ferizaj

Pretendimi kryesor ankimor ka të bëjë kundër propozimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues
Pretendimi nr.1:
AK na ka eliminuar me arsyeje se ne si OE nuk e plotësojmë listën e pajisjeve, konkretisht librezat për dy kamion nuk janë valide, pasi ju ka kaluar validiteti i regjistrimit sipas kritereve të AK –së:
AK në kriterin e kërkuar te FDT –së për listën e pajisjeve ka kërkuar:
Kapaciteti teknik dhe profesionale:
Kërkesa 6. Raporti për mjetet, stabilimentet dhe paisjet teknike që janë në dispozicionin tuaj për realizimin e projektit. Minimumi Kamion i rëndë me kapacitet min. 12 ton (5 Copë), Bager,(3 Copë), Rrafshues, (2 Copë), Cilinder (2 copë), Grider (1 copë), Auto mikser vetë ngarkues (1 copë). Në rast konzorciumi, lideri i grupit duhet të përmbushë 60% të kërkesës se pajisjeve ne pronësi.
Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Dëshmia 6. Një Listë e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që i ka në dispozicion kompania, duhet të dorëzohen në origjinal e nënshkruar dhe e vulosur, ose kontrata mbi marrjen me qira të paisjeve ne emër të projektit në fjalë. Për autmjetet që regjistrohen duhet të dorëzohen librezat e regjistrimit valide për kamion, duda doganor të lexueshëm për paisje që nuk regjistrohen, kontrata të shitblerjes apo fatura ose kontrata të marrjes me qira të pajisjeve për projektin në fjalë e cila duhet të jetë e vulosur dhe e nënshkruar nga të dy palët. Marrëveshjet apo kontratat e marrjes me qira të paisjeve. Në rast konzorciumi Lideri i grupit duhet të përmbush 60% e kërkesës për paisje.

Eksperti shqyrtues sqaron pretendimet e OE, Pas administrimit dhe shqyrtimit të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, operatori ekonomik "Linda" & "Euroinfrastruktura"- Ferizaj, si parashtrues i ankesës, vlerësojmë se ofrimi i librezave valide nga OE ankues është në pajtueshmëri të plotë me dispozitat e LPP-së neni 72, pasi është dokument ekzistenca e të cilit është e fiksuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive pasi që regjistrimin e fundit mbanë vulën dhe datën: 02.10.2022, kamionit me targa: 05-178-EG dhe kamioni me targa: 05-263-FD ka datën e regjistrimit: 25.08.2022, që do të thotë dy kamionët në fjalë janë regjistruar para afatit për dorëzim të tenderëve.

AK është njoftuar përmes kërkese për ri shqyrtim në të cilën OE e ka bërë me datën: 08.11.2022 ku janë bashkangjitur edhe provat në fjalë.

Bazuar në gjithë këto që u cekën më lartë vlerësojmë se ankesa e OE ankues është e bazuar dhe në bazë të nenit 59 dhe 72 të LPP –së, rekomandojmë që kjo lëndë të kthehet në rivlerësim.

Pretendimi ankimor për Operatorin ekonomik: "Bageri (Bujar Shabani B.I)"

Pretendimi kryesor ankimor ka të bëjë kundër propozimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues;
Pretendimi nr.1:
AK na ka eliminuar me arsyeje se ne si OE nuk e kemi ofruar librezën për auto mikser vetëngarkues sipas kërkesës së AK –së:
AK në kriterin e kërkuar te FDT –së për listën e pajisjeve ka kërkuar:
Kapaciteti teknik dhe profesionale:
Kërkesa 6. Raporti për mjetet, stabilimentet dhe paisjet teknike që janë në dispozicionin tuaj për realizimin e projektit. Minimumi Kamion i rëndë me kapacitet min. 12 ton ( 5 Copë),Bager,(3 Copë),Rrafshues,(2 Copë), Cilinder ( 2 copë), Grider ( 1 copë), Auto mikser vetë ngarkues ( 1 copë). Në rast konzorciumi, lideri i grupit duhet të përmbushë 60% të kërkesës se pajisjeve ne pronësi.
Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Dëshmia 6. Një Listë e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që i ka në dispozicion kompania, duhet të dorëzohen në origjinal e nënshkruar dhe e vulosur, ose kontrata mbi marrjen me qira të paisjeve ne emër të projektit në fjalë. Për automjetet që regjistrohen duhet të dorëzohen librezat e regjistrimit valide për kamion, duda doganor të lexueshëm për paisje që nuk regjistrohen , kontrata të shitblerjes apo fatura ose kontrata të marrjes me qira të pajisjeve për projektin në fjalë e cila duhet të jetë e vulosur dhe e nënshkruar nga të dy palët. Marrëveshjet apo kontratat e marrjes me qira të paisjeve. Në rast konzorciumi Lideri i grupit duhet të përmbush 60% e kërkesës për paisjea.

Eksperti shqyrtues sqaron pretendimet e OE; Pas administrimit dhe shqyrtimit të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, operatori ekonomik "Bageri (Bujar Shabani B.I) " Ferizaj si parashtrues i ankesës, vlerësojmë se mungesa e ofrimit të librezës valide për mikserin vetëngarkues sipas kërkesë së AK –së në dosjen e tenderit ku AK me datën: 28.10.2022 ka dërguar letrën standarde te OE duke e përdorur neni 72 të LPP -së: Letër standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit ku me datën: 31.11.2022 OE Bageri (Bujar Shabani B.I) ka kthyer përgjigjeje sipas kërkese së AK – së, por nuk është dëshmuar libreza valide sipas kërkesës.

Sqarim: Gjatë ditëve sa kamë shqyrtuar këtë ankesë të njëjtën kohë kamë kontaktuar me institucionet kompetentet si Qendra për Regjistrimin e Automjeteve MPB, Doganën e Republikës së Kosovës dhe Qendra e Automjeteve të Kosovës QAK lidhur me regjistrimin e mikserit

vetëngarkues dhe duke u bazuar në ligjin për automjete Ligji Nr. 05/L-132 Neni 39 paragrafi 3, në trafikun rrugor nuk mund të marrin pjesë mjetet e paregjistruara si motokultivatori dhe mjetet e punës. Nëse këto mjete marrin pjesë në trafikun rrugor duhet të jenë të regjistruara dhe t'i kenë sistemet dhe pajisjet e përcaktuara teknikisht në rregull. Gjithë ashtu ndërsa bazuar edhe ne ofertat te OE që kane ofertuar ne këtë aktivitet të prokurimit dëshmon qe regjistrohet mikserit ne fjalë.
Andaj, mendimi i ekspertit shqyrtues, pas shqyrtimit të pretendimit ankimor e vlerëson si të pabazuar pretendimin e OE në fjalë, pasi që OE nuk ka ofruar librezën valide sipas kërkese së autoritetit kontraktues dhe mos përmbushjen e neni 69 të LPP-së

Konform nenit 24 paragrafi 1 i Rregullores së Punës së OSHP-së 01/ 2020 e datës 03. 03. 2022 (e amandamentuar), paneli shqyrtues ka vlerësuar se në shkresat e kësaj lënde ka argumente dhe prova të mjaftueshme që vendimi meritor të merret edhe pa dëgjimin e palëve në seancë.

**Paneli shqyrtues** pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, "Linda" & "Euroinfrastruktura", si dhe OE ankues "Bageri" konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit të jashtëm shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi sqaron se, e mbeshtet raportin e perpiluar nga eksperti shqyrtues i prokurimt, që ankesen e OE ankues "Linda" & "Euroinfrastruktura"- Ferizaj, si parashtrues i ankesës, se ofrimi i librezave valide nga OE ankues është në pajtueshmëri të plotë me dispozitat e LPP-së neni 72, pasi është dokument ekzistenca e të cilit është e fiksuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive pasi që regjistrimin e fundit mbanë vulën dhe datën: 02.10.2022, kamionit me targa: 05-178-EG dhe kamioni me targa: 05-263-FD ka datën e regjistrimit: 25.08.2022, që do të thotë dy kamionët në fjalë janë regjistruar para afatit për dorëzim të tenderëve.

**PSH** e klasifikon të pabazuar pretendimin ankimor të operatorit ekonomik ankues "Bujar Shabani B.I " Ferizaj, dhe vlerësojmë se mungesa e ofrimit të librezës valide për Auto mikserin vetëngarkues dhe nuk e plotëson kërkesën e AK –së e vendosur në dosjen e tenderit.
AK me datën: 28.10.2022 ka dërguar letrën standarde te OE duke e përdorur neni 72 të LPP -së: Letër standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit ku me datën: 31.11.2022 OE Bujar Shabani B.I ka kthyer përgjigjeje sipas kërkese së AK –së, por nuk është dëshmuar libreza valide sipas kërkesës. Në bazë të kërkesës së Dosjes së Tenderit por edhe letrës standarde për sqarimin e tenderit AK e ri konfirmon se Auto mikseri vetëngarkues konsiderohet automjet që regjistrohet, Andaj, PSH në bazë të dokumentacionit të dorëzuar (ofertës) OE ankues ka ofruar mikser betoni (mikser vetëngarkues) në bazë të faturës dhe marrëveshjes mbi marrjen me qira dhe jo Auto mikser vetëngarkues.

Andaj nga te lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryetar i Paneli Shqyrtues

Vedat POTERQOI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- KK Shtimje

1x1 OE-ve ankues

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.